

## SHQIPËRI, O TOKA IME / ALBANIA, TERRA MIA

**TEKSTI / TESTO: FERDINAND BJANKU**  
**MUZIKA / MUSICA: FERDINAND BJANKU**  
**KËNDON / CANTA: FERDINAND BJANKU**

Ne shumë kemi ikur larg,  
të kemi lënë vetëm.  
Kërkuam gjetiu  
diellin, që të kanë vrejtur.  
Po në ne sa nostalgji!  
Shqipëri, Shqipëri  
o toka ime, o Shqipëri.

Nëse ka drejtësi,  
dhimbja jote do të mbarojë.  
Do ta gjesh ti paqen,  
e në qiellin tënd,  
dielli do të ndrijë përsëri.  
Shqipëri, Shqipëri  
o toka ime, o Shqipëri.

Kapërcej detin me mend  
dhe kthehem tek ti,  
ndër malet e tua,  
që ruajnë kujtimet e mia.  
Mbyll sytë, të shoh si je  
e lodhur, e trishtë dhe vetmuar  
ashtu si një nënë,  
që një nga një i humb të bijtë.  
E në ne sa nostalgji.  
Shqipëri, Shqipëri..  
O toka ime, o Shqipëri.

Nëse ka drejtësi,  
dhimbja jote do të mbarojë.  
Do ta gjesh ti paqen,  
e në qiellin tënd  
dielli do të ndrijë përsëri.  
Shqipëri, Shqipëri..  
O toka ime, o Shqipëri.

Ne jemi plot me mall,  
por, nuk të themi lamtumirë!  
Shqipëri, o toka ime  
Shqipëri.  
Një ditë do kthehemi, në Shqipëri!

Siamo andati lontano  
ti abbiamo lasciato sola.  
Cercando oltremare  
il Sole, che non si vedeva da te.  
Ma quanta nostalgia!  
Albania, Albania,  
terra mia, Albania.

*Rit.* : Il tuo dolore finirà  
se esiste la giustizia!  
troverai la pace,  
e sul tuo cielo  
il sole di nuovo splenderà!  
Albania, Albania,  
terra mia, Albania.

Attraverso il mare, con gli occhi della mente,  
e torno da te,  
sulle tue montagne,  
che conservano i miei ricordi.  
Chiudo gli occhi, e vedo te  
stanca, triste e sola,  
come una madre  
che ha perso uno ad uno i figli.  
E da noi quanta nostalgia!  
Albania, Albania,  
terra mia, Albania.

*Rit.* : Il tuo dolore finirà  
se esiste la giustizia.  
troverai la tua pace,  
e sul tuo cielo,  
il sole di nuovo splenderà!  
Albania, Albania,  
terra mia, Albania.

Ci manchi tanto,  
e mai ti diremo: Addio!  
Albania,  
terra mia, Albania!  
Un giorno torneremo: in ALBANIA!